



NA Prot. 1008-
04.05.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3807
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 05/10.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti I Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.105

Datë: 03.10.2023

“Për miratimin e listës të përdoruesve faktik të tokës bujqësore”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari I Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

3807/12/10/2

Nr.1008 /1 Prot.

Peshkopi, më 11.10.2023

Lënda: Për vendimin nr.105, datë 03.10.2023 të Këshillit Bashkiak Dibër

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

Bazuar në ligjin nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.105, datë 03.10..2023 "*Për miratimin e listës të përdoruesve faktik të tokës bujqësore*", protokolluar pranë institucionit tonë me nr.1008 prot., datë 05.10.2023, vendosa të miratoj në parim vendimin objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e përdoruesve faktik të tokës bujqësore, veprime që kurdoherë ngarkojnë me përgjegjësi direkte administrativo-ligjore strukturat e posaçme të institucioneve ligjzbatuese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 105 Datë 03 / 10 /2023

“ Për miratimin e listës të përdoruesve faktik të tokës bujqësore ”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “ Për vetë qeverisjen vendore ” Ligji nr. 20/2020 “ Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” shkresës nr. 4009 prot datë 06.12.2021, VKMnr. 1182 date 24.12.2020 “ Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”. Referuar shkresës të dërguar nga ASHK Dibër me nr.2338 prot date 24.07.2023 të protokolluar nga ana jonë me nr. 2817 prot datë 24.07.2023, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e dates **03.10.2023**, me 19 vota pro, 6 vota kundër dhe 5 apstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e përdoruesve faktik të tokës bujqësore sipas dokumentacionit të dërguar nga ASHK Dibër. Bashkëlidhur vendimit pjesë përbërëse e vendimit është listat e përdoruesve faktik të tokës bujqësore, hartat treguese, relacionet përkatëse.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmeri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
3. Pas miratimit të Vendimit nga Prefekti I Qarkut , vendimi ti dërgohet Drejtorisë Vendore të Kadastrës Dibër për ndjekjen e procedurave të mëtejshme në zbatim të ligjit nr. 20/2020 “ Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.
4. Vendimi u shpall me date **03.10.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irimi Shehu



Adresa: Bulevardi “Elezlsufi” Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 0035521822935